

VENDIM
Nr. 225, datë 26.4.2018
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE
TË KOMISIONIT TË NDIHMËS SHETETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si më poshtë vijon:
 - Z. Arben Ahmetaj kryetar;
 - Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
 - Znj. Etleva Haka anëtare;
 - Znj. Mirjana Zisi anëtare;
 - Z. Ahmet Mançellari anëtar.
 2. Trajtimi financiar i anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
 3. Vendimi nr. 55, datë 5.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.
 4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi